



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUŠTARA	
01 Nr. / Br.	249/12
Nr. i fq. / Br. st	-10-
Data / Datum 26.07.2012	
VUŠTARA - VUŠTARA	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Bazuar në nenin 12.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03.L-040, dhe nenin 41.2 "c" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më: 26.07.2012 aprovoi këtë:

**RREGULLORE  
PËR RREGULLIMIN, SIGURIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE NË  
TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

- 1.1 Me këtë rregullore përcaktohen çështjet e rregullimit, sigurimit dhe mirëmbajtjes së varrezave si dhe shërbimet e varrimit në varreza, në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.  
1.2 Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave është veprimtari komunale me interes të përgjithshëm.

**PËRKUFIZIMET**

**Neni 2**

Shpjegime të kuptimeve të fjalëve që përdoren në këtë rregullore:

- Varr - vendi për varrosjen e trupit (eshtrave) të vdekur.**  
**Varrim - vendosja e eshtrave të kufomës në vendin e caktuar.**  
**Varrezë - është toka e caktuar për varrim e përcaktuar sipas planit urbanistik të qytetit.**  
**Vende për varrim - është toka e caktuar për varrezë me gjithë lapidar (përmendore).**  
**BF - Bashkësia Fetare.**  
**NSHV - Ndërmarrja për Shërbimet e Varrimit.**  
**Shërbimet e varrimit - shërbimet të cilat kryhen gjatë procedurës së varrimit.**  
**Shfrytëzuesi i vend-varrit - person i cili përkujdeset për vend-varr.**  
**Leje për zhvarrosje - leje të cilën e lëshon organi kompetent i komunës për zhvarrosjen e të vdekurit.**  
**Çmimi i varrimit - çmim i propozuar nga NSHV-ja apo bashkësitetë fetare dhe i aprovar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, për mirëmbajtje dhe shërbime të varrimit.**  
**Prehja - pushim shpirtëror i të vdekurit.**  
**Dinjitet - tërësia e vlerave morale të të vdekurit.**  
**Person - person juridik ose person fizik.**

**DSHP** - Drejtoria për Shërbime Publike.  
**KKV** - Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.  
**ALE** - Hapësira në mes të dy varreve.

## **II. SIGURIMI, RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTA E VARREZAVE**

### **Neni 3**

Sigurimi dhe mirëmbajtja e varrezave nënkupton sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe mjeteve të cilat shërbejnë për kryerjen e shërbimeve të varrimit, sigurimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, aleve dhe hapësirave ndërmjet varreve, mirëmbajtjen e gjelberimit, rendit dhe pastërtisë, largimin e borës dhe akullit, përgatitjen e hapësirës për varrim si dhe kryerjen e punëve tjera, të cilat janë të lidhura me rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në veçanti.

### **Neni 4**

4.1 Në qytet si dhe në vendbanimet tjera në territorin e komunës, duke pasur parasysh se jetojnë pjesëtarë të besimeve të ndryshme fetare, mund të jenë në përdorim dy ose më shumë lokacione për varreza.

4.2 Varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave nëpër fshatra e bën komuniteti i fshatit në bashkëpunim me BF-në apo NSHV-në nën-mbikëqyrje të komunës.

### **Neni 5**

5.1 Toka (lokacioni) për varreza në qytet caktohet në përputhje me planin urbanistik të qytetit, ndërsa në vendbanime tjera, në territorin e komunës bëhet në përputhje me planin hapësinor.

5.2 Para caktimit të vendit (lokacionit) për varreza duhet pasur kujdes veçanërisht në mbrojtjen e burimeve dhe puseve prej nga banorët furnizohen me ujë, në mbrojtjen e ajrit si dhe mbrojtjen e kushteve të posaçme sanitare për ndërtimin e varrezave.

### **Neni 6**

KKV-ja, bazuar në planin urbanistik të qytetit dhe me vendim të veçantë, ka përcaktuar lokacionin për varreza të reja të qytetit në zonën kadastrale Begaj, fleta poseduese, nr.92 me sipërfaqe prej 12.36.44 ha.

### **Neni 7**

7.1 Në bazë të planit urbanistik dhe projektit të varrezave, hapësira në varreza, e dedikuar për varrosje, ndahet në parcela në brendi të të cilave ndodhen vendet për varrim, e të cilat evidentohen me numra. Vendet për varrim dizajnohen në madhësi maksimale 240x120 cm (duke përfshirë në këtë sipërfaqe edhe lapidarë eventual).

7.2 Distanca në mes varrezave duhet të jetë 50 cm.

7.3 Arkitektura e vendeve për varrim rregullohet në bazë të planeve rregullative detaile dhe Rregullores së veçantë të BF-ve.

7.4 BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar që të udhëheq dhe të evidentojë nga strukturat vendet e varrit me emrat e personave të vdekur, datën e varrimit si dhe shërbimet tjera të lidhura me varrim.

### **Neni 8**

8.1 Kuvendi i komunës sipas procedurës për dhëni në shfrytëzim të pronës (tokës) komunale, duke u bazuar në procedurën e ligjit mbi prokurim, përzgjedh përfituesin i cili do të jetë përgjegjës për menaxhim dhe mirëmbajtje të varrezave të qytetit.

8.2 BF-ja apo NSHV-ja kryen shërbime sipas dispozitave të kësaj rregulloreje në përputhshmëri me çmimin e propozuar nga biznesi përmes DSHP-së dhe të aprovuar nga KKV-ja.

#### Neni 9

9.1 Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave bëhet në bazë të planit vjetor të cilin e propozon BF-ja apo NSHV-ja e të cilën e miraton KKV-ja.

9.2 Përkujdesje të veçantë kuvendi komunal do t'i kushtojë varrezave të dëshmorëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

9.3 Programi nga paragrafi 1 i këtij nenit përmbanë: llojin, masën, dinamikën e punëve, si dhe shumën e mjeteve të nevojshme për realizimin e tyre.

9.4 BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar që Drejtorisë për Inspektime t'ia paraqes planin për mirëmbajtje të zbërthyer në muaj për vitin vijues, më së largu 10 ditë pas miratimit të programit nga paragrafil.

9.5 Planet harmonizohen me programin e aprovuar nga KKV-ja.

#### Neni 10

Për mirëmbajtjen dhe rregullimin e vendeve të varrit përkujdesen shfrytëzuesit, familja e afërt dhe farefisi.

#### Neni 11

11.1 BF-ja gjatë mirëmbajtjes duhet domosdoshmërisht t'i përbahet rregullave dhe projektit të varrezave.

11.2 Ndryshimet eventuale mund t'i bëjë BF-ja apo NSHV-ja vetëm me pëlqim të DSHP-së dhe aprovim të KKV-së.

#### Neni 12

12.1 Të drejtat dhe përgjegjësitë e BF-së apo NSHV-së përcaktohen me kontratë të veçantë.

12.2 KKV-ja mbanë të drejtën që në rast të mosrespektimit të elementeve të kontratës të shkëputë kontratën.

#### Neni 13

13.1 Për vendosjen, riparimin si dhe zhvendosjen e pllakave dhe mjeteve tjera në vendet e varrit është i obligueshëm pëlqimi i BF-së apo NSHV-së.

13.2 Për ndërhyrjen e çfarëdo pune në lapidar (pllakë përkujtimore) ose ndonjë pjesë në varrezë, e cila ka karakterin e lapidarit kulturor, është i nevojshëm pëlqimi me shkrim nga institucioni, i cili merret me mbrojtjen e monumenteve kulturore.

13.3 BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar që ta informojë Drejtorisë për Inspektime për ekzekutimin e punëve pa pëlqim nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij nenit.

#### Neni 14

Aktivitetet zejtare në varr, për të cilat është siguruar pëlqimi bazuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje kryhen duke i respektuar këto kriterë:

14.1 Gjatë aktiviteteve të ceremonisë së varrimit, të mbahet qetësia në varreza.

14.2 Materiali ndërtimor (rërë, cement etj) është i lejuar të mbahet në varreza për një kohë sa më të shkurtër e cila është e nevojshme për kryerjen e punëve, por të mos jetë pengesë për lëvizjen e vizitorëve. Pas mbarimit të punëve ekzekutuesi është i obliguar që vendpunimin menjëherë ta kthejë në gjendjen e mëparshme.

14.3 Transporti i materialit (për rregullim në varreza) të bëhet vetëm në rrugët dhe aletë të cilat i përcakton BF-ja apo NSHV-ja.

14.4 Nëse gjatë kryerjes së punëve gjenden arkivole dhe gjëra të tjera, punët duhet të ndërpriten dhe menjëherë duhet lajmëruar BF-ja apo NSHV-ja.

14.5 Nëse gjatë kryerjes së punëve gjenden mjete me vlerë menjëherë të informohen organet kompetente.

14.6 BF-ja apo NSHV-ja mund të ndërpresë punët në varreza apo në një pjesë të varrezave në kohë të caktuar të ditës, apo në ditë të caktuara.

14.7 Ekzekutuesve të punëve të cilët nuk i përbahen dispozitave të këtij neni lidhur me respektimin e qetësisë në varreza, BF-ja apo NSHV-ja i informon organet kompetente për të ndaluar aktivitetet ndërtimore në varreza.

#### Neni 15

15.1 Në varre është e lejuar mbjellja e luleve dekorative të rritjes së ulët të cilat nuk pengojnë varret tjera pérreth.

15.2 Drunjtë e mbjellur nga komuna mund të mënjanohen, krasiten vetëm me pëlqim të DSHP-së.

#### Neni 16

BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar të mënjanojë të gjitha mjetet dhe të mbjellurat të cilat janë të vendosura pa pëlqimin e DSHP-së.

#### Neni 17

BF-ja apo NSHV -ja e cila menaxhon në varreza të qytetit është e obliguar që:

17.1 Aktivitetet të jenë në pajtueshmëri me projektin e aprovar pér rregullim të varrezave.

17.2 Në bazë të projektit dhe përpunimit detaj urbanistik të bëjë përcaktimin e vendeve pér varrim.

17.3 Të mirëmbajë rrugët dhe aletë.

17.4 Të kujdeset pér mirëmbajtjen dhe mosdëmtimin e rrethojës.

17.5 Të ketë përkujdesje të veçantë pér varrezat e dëshmorëve.

17.6 Në fund të çdo viti kalendarik të hartojë planin e punës pér vitin e ardhshëm kaldendarik, dhe propozimin t'ia dorëzojë KKV-së përmes Drejtorisë pér Shërbime Publike.

17.7 Qytetarëve t'ua jep në shfrytëzim vendin e lirë sipas radhës në varreza në pajtim me këtë rregullore.

17.8 Të kryejë shërbimet në lidhje me varrmin dhe transportin e eshtrave (duke përfshirë edhe gërmimet eventuale).

17.9 Të mbajë librin amzë të varrimit, posaçërisht pér secilin varr, me përshkrim të hollësishëm të vendit (parcelës së varrimit).

17.10 Të mbajë evidencën e varrezave, lapidarëve etj.

17.11 Të mbajë evidencën e bartësit të së drejtës së shfrytëzimit të vendit-parcelës së varrimit.

17.12 Të mbajë evidencën e parcelës së varrimit.

17.13 Të mbajë evidencën e varrezave të qytetarëve të merituar.

17.14 Të kryejë punë tjera në mirëmbajtje, rregullim dhe mbrojtje të varrezave të cilat do të përcaktohen me kontratë.

17.15 Pér pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, viktimate civile dhe familjeve të tyre ka benificione te veçanta sipas nenit 6.9 të Ligjit pér Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimate Civile dhe familjeve të tyre.

### **III. VARRIMI**

#### **Neni 18**

18.1 Me varrim nënkuptohet varrosja e të vdekurit, përkatësisht vendosja e eshtrave të kufomës në vendet e caktuara.

18.2 Varrosja bëhet pasi të jetë konstatuar vdekja e përcaktuar me dispozita ligjore.

#### **Neni 19**

19.1 Pas konstatimit të vdekjes nga ana e mjekut, familja, përkatësisht personi që përkujdeset për varrosje është i obliguar që në afat sa më të shpejt ta njoftojë BF-në apo NSHV-në për vdekjen e personit me qëllim të organizimit të bartjes dhe varrosjes në varreza.

19.2 Organizimin në tërësi të varrimit, që nga bartja e bënë BF-ja apo NSHV-ja që menaxhon me varreza.

#### **Neni 20**

20.1 BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar që bartjen e kufomës (që ka ndërruar jetë jashtë institucioneve shëndetësore) ta sigurojë çdo ditë prej 00 deri 24.

20.2 Bartja duhet të bëhet të njëjtën ditë kur nga ana e mjekut është konstatuar vdekja, përvçe rasteve specifike.

#### **Neni 21**

21.1 BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar që të sigurojë çdo ditë personelin për shërbime të varrimit.

21.2 Personeli i cili bënë varrimin duhet që të ketë veshjen përkatëse, në përputhje me rregullat e varrimit.

#### **Neni 22**

22.1 Vendi për varrim i jepet në shfrytëzim farefisit të të ndjerit dhe atë: bashkëshortit të ndjerit-ës, fëmijëve (me kurorë, jashtë-kurorës, të falur) prindit të të ndjerit etj.

22.2 KKV-ja do t'i mbulojë (sigurojë) shpenzimet e varrimit (përfshirë edhe varrosjen) për qytetarët të cilët nuk kanë farefis dhe nuk kanë qenë nënpërkujdesje të askuji.

22.3 Përjashtimi nga parografi 1 dhe 2 të këtij nenit, vendi i varrit i ipet në shfrytëzim personit i cili siguron varrimin e të ndjerit.

#### **Neni 23**

Në qytet kufoma bartet për në varr me arkivol (tabut), të cilën mund ta bartin BF-ja apo NSHV-ja me mjete të caktuara motorike për këtë qëllim.

#### **Neni 24**

Vendi i varrit që është dhënë në shfrytëzim nuk mund të tjetërsohet.

#### **Neni 25**

25.1 Varrosja bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore si dhe rregullat fetare duke respektuar dinjitetin e të vdekurit.

25.2 Kufoma e të vdekurit nuk mund të zhvarroset, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet nga organet e hetuesisë për nevoja të ekspertizës.

25.3 Kufoma e të vdekurit bartet nga varrezat ekzistuese para skadimit të afatit të obligueshëm ligjor.

**25.4 Afati i obligueshëm ligjor që nga fillimi gjérë te hapja e varrit (zhvarrosja) është së paku 10 vjet.**

**Neni 26**

Mihja dhe mbushja e varrit, përkatësisht mbyllja e varrit në varreza të qytetit bëhet nga BF-ja apo NSHV-ja, ndërsa në vendbanimet tjera për këto punë obligohen bashkëfamiljarët e të ndjerit ose personat tjerë (komuniteti).

**Neni 27**

Eshtrat e kufomës, të cilës i ka skaduar afati obligues i prehjes, nuk mund të zhvarrosen në intervalin kohor prej 1 majit deri më 30 shtator.

**Neni 28**

28.1 Bashkë me kërkesën për varrim ose bartje të eshtrave të kufomës, paraqitësi i kërkesës është i obliguar të paraqesë dëshminë mbi pëlqimin e bashkëfamiljarëve më të afërt të të ndjerit ose personit të autorizuar për shfrytëzimin e varrit.

28.2 Për bartjen e eshtrave nga një varr në tjetrin nevojitet leja e organit kompetent të komunës, duke u bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë këtë lëmi.

28.3 Pas mbarimit të ceremonisë së varrimit, përkatësisht varrosjes, personeli që ka kryer punët është i obliguar që vendin e varrit ta rregullojë sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

**Neni 29**

29.1 Varrosja e kufomës së të ndjerit bëhet në varrezën e cila është në shfrytëzim të rregullt, përjashtimisht jashtë varrezave të cilat janë në përdorim, e që mund të bëhet varrimi vetëm me lejen e organit kompetent të administratës komunale dhe të BF-së përkatëse.

29.2 Vendi për varrim jashtë varrezave në përdorim të rregullt përcaktohet me plan urbanistik.

29.3 Ndalohet varrosja e kufomave në varrezat e qytetit të konservuar me vendim të KKV-së.

**Neni 30**

30.1 Nëse në varrezat ekzistuese nuk ka vend për varrim për shkak të zgjerimit të vendbanimit, për arsyen sanitare ose varrezat ekzistuese nuk i përgjigjen kushteve, KKV-ja merr vendim me të cilin varrezat e tillë pushojnë të janë në funksion të përdorimit.

30.2 Vendimin nga alineja 1 e këtij nenit, KKV-ja e merr në bazë të të dhënave të komisionit të posaçëm (për çështjen në fjalë) profesional.

**Neni 31**

31.1 Varrezat të cilat karakterizohen si varreza jashtë përdorimit pas skadimit të afatit për përdorim do të konservohe.

31.2 Periudha e konservimit të kompleksit të varrezave duhet të zgjasë prej 40 deri 50 vjet. Pas këtij afati mund të shndërrohen në park apo hapësirë gjelbëruese me vendim të veçantë të KKV-së.

31.3 Varrezat e karakterit monumental-historik janë të përhershme.

31.4 Shfrytëzuesit e vendvarimeve të varrezave të tillë për kohën e mbetur, kanë të drejtë shfrytëzimi në një vendvarrim tjetër.

### Neni 32

- 32.1 Varri mund tē jenë pēr person ose mund tē jenë varre familjare.
- 32.2 Në varrin pēr person varroset vetém një person, kurse në varret familjare nē një lokacion tē caktuar varrosen mē shumë tē afërm.
- 32.3 BF-ja apo NSHV-ja që menaxhon nē varreza mund tē lejojë varrimin nē një varr tē eshtrave tē personit tē vdekur që nuk bënë pjesë nē radhën e personave nga alineja 1 e këtij neni, me kërkesë ose nē marrëveshje me personat që gëzojnë tē drejtën e shfrytëzimit.

## IV. RREGULLI NË VARREZA

### Neni 33

- 33.1 Varrezat janë tē hapura pēr vizitorë çdo ditë.
- 33.2 BF-ja apo NSHV-ja me pëlqim tē DSHP-së nē raste tē jashtëzakonshme, mund tē bëjnë pērkohësisht ndalesën e vizitorëve nē varreza.

### Neni 34

- 34.1 Vizitorët dhe shfrytëzuesit e vendvarrimit janë tē obliguar t'i përbahen urdhëresës dhe udhëzimeve tē cilat i japin personat e autorizuar tē BF-së apo NSHV-së.
- 34.2 Vizitorët janë tē obliguar që tē mbajnë qetësi gjatë vizitave nē varreza, me qëllim tē respektimit tē dinjitetit tē tē ndjerëve.

### Neni 35

BF-ja apo NSHV-ja me akt tē veçantë mund tē rregullojë kohën e kryerjes së varrimit, e cila duhet tē jetë konform kësaj rregulloreje.

### Neni 36

Në varreza është e ndaluar:

- 36.1 Shkelja, njollosja, shkaravatja dhe dëmtimi i vendeve tē varrimit (duke përfshirë edhe gurët e varrezave).
- 36.2 Hyrja e fëmijëve tē moshës nën 10 vjeçare pa përcjelljen e personave tē rritur.
- 36.3 Kalimi i rrethojës, shkelja e sipërfaqeve tē gjelbëruara, thyerja e drunjve dhe këputja e luleve dhe bimëve tjera dekorative.
- 36.4 Mosmbajtja e qetësisë nē varreza.
- 36.5 Futja dhe kullosja e kafshëve nē varreza.
- 36.6 Ngasja e bicikletave nē rrugë dhe ale, sipërfaqe tē gjelbëruara, hedhja e luleve tē vyshkura etj nē varreza.
- 36.7 Fotografimi me qëllim tē kryerjes së shërbimeve komerciale pa lejen e BF-së apo NSHV-së.
- 36.8 Shitia e çfarëdo malli nē varreza pa lejen e BF-së apo NSHV-së.
- 36.9 Hedhja dhe djegia e mbeturinave nē varreza.
- 36.10 Të zhvillohen veprimtari ndërtimore nē varreza pa lejen e BF-së apo NSHV-së.
- 36.11 Montimi i ulëseve, rrethojave nëse nuk janë paraparë me projekt.
- 36.12 Mbjellja e drunjve përreth varrit pa pëlqimin e BF-së apo NSHV-së.
- 36.13 Djegia e barit nē varreza, pa lejen pararpake tē BF-së apo NSHV-së.

### Neni 37

Sipas kësaj rregulloreje, BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar që ta vendos nē vend tē dukshëm nē hyrje tē varrezave udhëzimin dhe urdhëresën me tē cilën parashihet mbajtja e qetësisë.

## **V. MJETET E NEVOJSHME PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE**

### **Neni 38**

38.1 Komuna merr përsipër të gjitha obligimet për mirëmbajtjen dhe rregullimin e varrezave.

38.2 Mjetet për kryerjen e shërbimeve për varrim sigurohen nga shuma që e paguajnë shfrytëzuesit në bashkësitë e tyre fetare.

### **Neni 39**

39.1 Varrimin dhe shërbimet tjera për varrim i kryejnë bashkësitë fetare.

39.2 BF-ja apo NSHV-ja në bazë të shërbimeve të planifikuara llogaritë dhe përcakton çmimin e shërbimeve të cilin ia propozon KKV-së për aprovim, përmes DSHP-së.

39.3 Kompensimi i shërbimeve nga alineja 1 i këtij nenit kryhet edhe në rastin e zhvarrosjes së eshtrave të të vdekurit.

### **Neni 40**

Për rregullimin, mirëmbajtjen e objekteve në varreza, si dhe shfrytëzimin e shërbimeve në varreza (mirëmbajtja e rrugëve dhe aleve, gjelbërimi, ndriçimi publik, qetësisë dhe pastërtisë) është kompetente Komuna e Vushtrrisë.

## **VI. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E KUVENDIT TË KOMUNËS**

### **Neni 41**

Në raste të jashtëzakonshme kur vjen deri te çrrregullimi ose ndalimi i kryerjes së punëve në rregullim dhe mirëmbajtje të varrezave për shkak të "fuqisë madhore", BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar që menjëherë pa hezitim të ndërmerri aktivitetë në eliminimin e shkaktarit të çrrregullimit duke vepruar me sa vijon:

41.1 Angazhon personelin që të evitojë shkaqet që çrrregullojnë mirëmbajtjen e varrezave.

41.2 Urgjentisht riparon dhe ndërron instalimet dhe mjetet të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e punëve, mbron objektet komunale dhe mjetet tjera nga prishjet dhe avaritë eventuale.

41.3 Ndërmerri masa tjera të cilat i përcaktor DSHP-ja.

### **Neni 42**

Bazuar në alinenë 1 të nenit 41 të kësaj rregulloreje, BF-ja apo NSHV-ja është e obliguar që krahas ndërmarrjes së masave të lajmërojë DSHP-në për shkaqet e çrrregullimit dhe ndalimit, si dhe aktivitetet e ndërmarra.

DSHP-ja në përputhje me alinenë 1 të nenit 41 është e obliguar që menjëherë të:

42.1 Jep urdhër për mbrojtjen e objekteve dhe pronës komunale të cilat janë të rrezikuara.

42.2 Propozojë masa për eliminimin e pasojave, si dhe masa tjera me qëllim të vënies në dispozicion të shërbimeve komunale.

42.3 Mund të angazhojë BF-në apo NSHV-në tjetër për kryerje, rregullim, mirëmbajtje të varrezave deri në eliminimin e çrrregullimeve eventuale.

42.4 Vërtetojë shkaqet, eventualisht përgjegjësitet për çrrregullim si dhe përgjegjësinë për kompensimin e dëmeve.

## VII. MASAT NDËSHKUESE

### Neni 43

NSHV-ja e cila menaxhon në varreza do të gjobitet për kundërvajtje prej 500 deri 1.000 € nëse:

- 43.1 Vepron në kundërshtim me nenin 7 alineja 2 të kësaj rregulloreje.
- 43.2 Vepron në kundërshtim me nenin 9 alineja 1 dhe 3 të kësaj rregulloreje.
- 43.3 Vepron në kundërshtim me nenin 11 të kësaj rregulloreje.
- 43.4 Vepron në kundërshtim me nenin 17 të kësaj rregulloreje.
- 43.5 Vepron në kundërshtim me nenin 18 alineja 2 të kësaj rregulloreje.
- 43.6 Vepron në kundërshtim me nenin 21 të kësaj rregulloreje.
- 43.7 Vepron në kundërshtim me nenin 23 alineja 1 të kësaj rregulloreje.
- 43.8 Vepron në kundërshtim me nenin 24 alineja 3 të kësaj rregulloreje.
- 43.9 Personi përgjegjës i NSHV-së do të gjobitet prej 100-300 € nëse vepron në kundërshtim me alinenë 1 të këtij neni.
- 43.10 Personi fizik gjobitet prej 500 deri 1000 € në qoftë se vepron në kundërshtim me nenin 29 të kësaj rregulloreje.

### Neni 44

Në shumë prej 1.000 deri në 1.500 € do të ndëshkohet personi juridik për kundërvajtje nëse ekzekuton shërbime zeztare të ndaluara sipas nenit 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje nëse:

- 44.1 Nuk siguron pëlqimin me shkrim nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, sipas nenit 13, alineja 2 e kësaj rregulloreje.
- 44.2 Vepron në kundërshtim me nenin 14, alineja 1 e kësaj rregulloreje.
- 44.3 Personi përgjegjës i NSHV-së do të gjobitet për kundërvajtje prej 100-300 € nëse vepron në kundërshtim me nenin 14, alineja 1 e kësaj rregulloreje.

### Neni 45

Personi fizik do të gjobitet prej 100-200 € për kundërvajtje nëse:

- 45.1 Vepron në kundërshtim me nenin 13 e kësaj rregulloreje.
- 45.2 Vepron në kundërshtim me nenin 14 e kësaj rregulloreje.
- 45.3 Vepron në kundërshtim me nenin 24 alineja 3 e kësaj rregulloreje.
- 45.4 Vepron në kundërshtim me nenin 35 e kësaj rregulloreje.

### Neni 46

46.1 Personi juridik do të gjobitet në shumë prej 500 €, ndërsa personi përgjegjës në shumën prej 250 € për kundërvajtje nëse zhvillon aktivitete në varreza pa pëlqimin e NSHV-së apo bashkësive fetare që menaxhojnë varrezat.

46.2 Personi fizik gjobitet në shumën prej 100 €, nëse vepron në kundërshtim me nenin 14 të kësaj rregulloreje.

46.3 Personi fizik do të gjobitet në shumë prej 100-200 €, nëse vepron në kundërshtim me nenin 35 të kësaj rregulloreje.

46.4 Nëse BF-ja apo NSHV-ja nuk kryen obligimet konform kësaj rregulloreje, Drejtoria për Inspektime do të ngrejë procedurën për kundërvajtje në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Vushtrri.

## **VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 47**

Shërbimet e bartjes së kufomës për në varreza të qytetit i bënë BF-ja apo NSHV-ja, e cila menaxhon varrezat, ndërsa në fshatra varrimi bëhet sipas traditës.

### **Neni 48**

Varrezat e vjetra të qytetit konsiderohen edhe më tej varreza të qytetit, dhe për të njëjtat do të zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje, deri në skadimin e afatit të shfrytëzimit të tyre.

### **Neni 49**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Inspektime dhe BF-të apo NSHV-ja, e cila menaxhon varrezat e qytetit.

### **Neni 50**

Deri në zgjedhjen e NSHV-së, përgjegjës për kryerjen e ceremonive të varrimit do të janë bashkësítë fetare së bashku me komunitetet, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

### **Neni 51**

Çdo gjë që nuk parashev kjo Rregullore, mund të rregullohet me akte normative që i vendos KKV-ja, ose BF-ja apo NSHV-ja në harmoni me ligjet në fuqi.

### **Neni 52**

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

### **Neni 53**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja e vitit 2006, për Shërbimet e Varrimit dhe Mirëmbajtjen e Varrezave të Qytetit.

